



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA MEMALIAJ**  
**AUTORITETI KONTRAKTOR**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Memaliaj më, 04.06.2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Pune**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Rikonstruktion i Ures ne lagjen Celaj Toc”**

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-28518-11-07-2024

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): CPV- 42414220-9

VLERA E FONDIT LIMIT: \_ **1.249.346** *(nje milion e dyqind e dyzet e nente mije e treqind e dyzet e gjashte) lekë pa tvsh*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Bashkia Memaliaj ka hartuar procesverbalin për

argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

*Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit pika 1 e kësaj shtojce (Shtojca 7).*

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2021, 2022, 2023**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

***Shënim :** Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitetet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023.*

*Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

*Kriteri për piken 2.2.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.*

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në licensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licensën

përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit, operatori ekonomik duhet të disponojë kategoritë e mëposhtme në liçensë:**

- **Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:**
- **NP-1 B**
- **NP4-D**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, ku janë të disiplinuarat procedurat përkatëse të licencimit të subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit. Gjithashtu, kjo kërkesë referohet edhe në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, ku neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore...”.

Pikat dhe kategoritë e kërkuara në licencë, janë përcaktuar në bazë të zërave dhe vlerave të parashikuara në preventivin e punimeve të projekt-zbatimit.

Për sa më lart, me qëllim realizimin e punës objekt prokurimi, është kërkuar që ofertuesit të jenë të pajisur me Licencë profesionale për kategoritë, të cilat janë vendosur sipas volumeve të punimeve dhe vlerave që përmban preventivi për çdo zë pune mbështetur në VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ku janë përcaktuar kategoritë dhe nënkategoritë përkatëse. Kjo kërkesë është vendosur me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të ofertuesve në kuadër të veprimtarisë objekt prokurimi.

\* Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i licensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

**\* Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marreveshjes.**

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë një punësimin mesatar jo më pak se **5 punonjës** për periudhën **3 (tre) muajt** e fundit nga data e hapjes së ofertave, ku përfshihen edhe drejtuesit teknik, stafi mbeshtetes, specialistet dhe punetoret per realizimin e kesaj kontrate.

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të punonjësve në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë:

1. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
2. Listëpagesat e Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

*Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht, në përcaktimin e numrit të punonjësve që duhet të ketë shoqëria ofertuese, janë analizuar dhe janë marrë në konsideratë volumet, orët e punës, zërat, kategoritë dhe kompleksiteti i punimeve, kualifikimi i punonjësve (ku përfshihet stafit organizativ, administrativ, tekniko-inxhinierik dhe ai mbështetës), grafiku i punimeve dhe shpërndarja e kantierit etj. Vendosija e këtij kriteri është teknikisht i argumentuar, pasi i përgjigjet përmasave të kontratës që prokurohet si për nga fondi limit, kohështrirja, por edhe për nga natyra e punimeve duke marrë në analizë manualin teknik të punimeve të ndërtimit në fuqi. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje minimalisht muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, tregon besueshmërinë e nevojshme për autoritetin kontraktor lidhur me përmbushjen e kontratës nga OE. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të Operatorit Ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është detyrim i punëdhënësit sipas parashikimeve të legjislacionit të fushës dhe Kodit të Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarëve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat e kualifikimit, përveç besueshmërisë së Operatorëve Ekonomikë, përpigjet të kufizojë edhe problematikat sociale

dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, dhe njëkohësisht është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës së punonjësve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore si dhe listëpagesat e punonjësve, mbështetur në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t’i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

:

**2.3.3.** Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf Teknik (specialist, punëtor) për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse/certifikatë e arsimit profesional) sipas ligjit Nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.Sh.” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Teknik ndertimi
- 1 ( nje) Teknik/Inxhinier Topograf
- 1 ( nje) manovrator
- 2 ( dy) shofer

Per manovratorët dhe shoferët kur mjetet/ makineritë **disponohen me qera**, ky staf i kërkuar mund të jetë i kontraktuar, **dhe në çdo rast, në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të paraqiten**

- Kontratë Individuale e Punës (të vlefshme),
- Dëshmi Kualifikimi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar).
- Çertifikatën e Aftësisë Profesionale përkatëse (CAP) për shoferët dhe Dëshmi e aftësisë profesionale për manovratorët

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës

*dhe zërat e punimeve. Nevoja për stafin mbështetës të kërkuar në objekt, është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Nëpërmjet këtij stafi, synohet realizimi i objektit të kontratës brenda afatit, normave dhe me cilësi sipas standardeve në fuqi. Staf mbështetës është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.*

**1.3.4 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:**

Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

<b>N r</b>	<b>LLOJI I MAKINERIVE</b>	<b>PRONESIA</b>	<b>SASIA Minimumi</b>
	Kamion vet shkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 5 ton	Ne pronesi ose me qera	1 cope
	Fadrome me goma	Ne pronesi ose me qera	1 cope
	Minieskavator	Ne pronesi ose me qera	1 Cope
	Vibrator Betoni	Ne pronesi ose me qera	1 cope
	Betoniere	Ne pronesi ose me qera	1 cope

- a) Për mjetet që shihen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikatën e pronesisë së mjetit.
- b) Për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje e qarkullimit) plus çertifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), taksat vjetore dhe çertifikatën e pronesisë së mjetit si dhe duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale të qerës, vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

*e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë minimalisht mjetet e pajisjet teknike të nevojshme për ekzekutimin e punimeve, me qëllim për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.*

*Numri dhe lloji i mjeteve, makinerive e pajisjeve të cilat duhet të disponohen nga OE në një rënë prej formave të kërkuara, janë vlerësuar si të nevojshme, në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke iu referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve objekt kontrate. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike sa i përket disponimit të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, e për këtë qëllim janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqiten si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave të përcaktuara. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në përcaktimin e numrit të punonjësve dhe mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e punimeve objekt kontrate, janë marrë në konsideratë përcaktimet e bëra në manualin e çmimeve në fuqi, si dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore.*

Cdo ofertues duhet të paraqese grafikun e punimeve të firmosur dhe vulosur nga administratori.

Ne rast BO grafikun e punimeve duhet të jete i firmosur dhe vulosur nga secili prej administratoreve perkates.

#### **Afati i kryerjes së punimeve:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesi grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

#### **Shënim:**

Mosdorëzimi i informacionit të saktë apo dorëzimi me të dhëna të rreme, do të konsiderohet kusht për s'kualifikim dhe/ose fillim të hetimit administrativ për përjashtimin e Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Në rast se Operatorët Ekonomikë do të paraqesin dokumentacion në gjuhë të huaj, dokumentat duhet të përkthehen në shqip dhe të noterizohen.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Njesia e Prokurimit